

Ceremonia përmbyllëse e projektit "Mbështetje për Sekretariatit për Çështje Evropiane"



Zëvendëskryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përgjegjës për Çështje Evropiane, Dr. Arbër Ademi bashkë me ambasadorën gjermane SH.S. z-nja Kristine Althauzer morën pjesë në ceremoninë përfundimit të projektit të suksesshëm të implementuar "Mbështetje për Sekretariatit për Çështje Evropiane" nga ana e shoqërisë Gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar GIZ dhe Sekretariatit për Çështje Evropiane.

Në fjalimin e tij Zëvendëskryeministri Ademi theksoi rëndësinë e bashkëpunimit bilateral mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë, si dhe mbështetjes nga ana e qeverisë së Gjermanisë në implementimin e reformave të nevojshme për vazhdimin e rrugës euro-atlantike, i cili mbetet qëllimi ynë strategjik.

Ky projekt zgjati tre vite dhe gjatë implementimit të tij u realizuan më shumë se 40 aktivitete, në të cilat mes punëtorive, trajnimeve dhe prezantimeve morën pjesë rreth 1600 veta, ndërkaq u publikuan sërë studime dhe publikime për nevojat e Sekretariatit dhe institucioneve tjera

shtetërore.

[Më shumë](#)

Takimi i 13-të i Komitetit për Stabilizim dhe Asociim mes Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian

Komiteti për Stabilizim dhe Asociim mes Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian sot, 15 qershor 2016 në Shkup, mbajti takimin e trembëdhjetë të punës.



Nga ana jonë takimi u kryesua nga Ana Blazheska, sekretar shtetëror në Sekretariatit për Çështje Evropiane të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë kurse nga ana e Komisionit Evropian u kryesua nga David Kulen, Shef i Njësisë për Republikën e Maqedonisë në Drejtorinë për Zgjerim dhe Politikë të Fqinjësisë nga ana e Komisionit Evropian.

Takimi i Komitetit për Stabilizim dhe Asociim rrumbullaksoi ciklin e shtatë nënkomiteteve sektoriale në kuadër të procesit të Stabilizim -Asociimit duke filluar nga muaji shkurt i këtij viti. Rezultatet nga takimi i realizuar i Komitetit do të prezantohen në kuadër të këshillit për Stabilizim dhe Asociim, i cili do të mbahet në korrik të vitit 2016.

[Më shumë](#)

Fjala e Zëvendëskryeministrit Ademi në ceremoninë me rastin e marrjes së kryesisë së grupit të Vishegradit

Sot me 27.06.2016 në hapësirat e BE Info Qendrës u realizua ceremonia me rastin e marrjes së kryesisë së grupit të Vishegradit të Republikës së Polonisë ku fjalën e tij kishte edhe Zëvendëskryeministri i Qeverisë përgjegjës për Çështje Evropiane Dr. Arbër Ademi.



Vendet e grupit të Vishegradit janë shembuj të mirë për bashkëpunim të cilat mund të merren në rastet e vendeve të Ballkanit Perëndimor, në veçanti nëse marrim parasysh se ne ndajmë vizion të njëjtë të jemi anëtarë të BE" -së theksoi Ademi dhe falënderoi për bashkëpunimin e ndërsjellë dhe të fuqishëm të grupit të Vishegradit në procesin eurointegrues të vendit.

[Më shumë](#)

U realizua Komiteti i njëmbëdhjetë Sektorial Monitorues TAIB

Sot, 16.06.2016, u realizua Komiteti i njëmbëdhjetë Sektorial Monitorues për IPA Komponentën I - asistencë gjatë tranzicionit dhe përforsim institucional. Bashkë kryesues të takimit ishin Zëvendëskryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përgjegjës për Çështje Evropiane Dr. Arbër Ademi dhe z. David Kulen nga Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësi dhe negociata për zgjerim në Komisionin Evropian.



Në takim u diskutua për progresin në realizimin e projekteve në kuadër të kësaj komponente. Gjithashtu u mbajtën dhe takimet themeluese të Komitetit Sektorial Monitorues për sundimin e së drejtës dhe komiteti monitorues IPA në kuadër të IPA 2. Këto dy takime u kryesuan nga Sekretari Shtetëror në Sekretariatit për Çështjet Evropiane Z-nj. Ana Blazheska dhe z. David Kulen.

[Më shumë](#)

Takime Pune

Takim i Zëvendëskryeministrit Ademi me SH.T. z. Jaček Stefan Multanovski

Në fillim të takimit, Zëvendëskryeministri Ademi theksoi se integrimi evropian mbetet prioritet kyç strategjik dhe alternativë e vetme për të ardhmen e vendit, e cila akoma ka mbështetje të lartë nga qytetarët si dhe u falënderua për mbështetjen e Polonisë për integrimin euro-atlantik të Maqedonisë dhe qëndrimin e saj se procesi i zgjerimit nuk do të mbaroj derisa nuk kyçen të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor në BE



Nga aspekti i gjendjes aktuale politike në vend gjatë bisedës bashkëbiseduesit bashkërisht u pajtuan se në këtë moment me rëndësi është të gjendet zgjidhje për të gjitha çështjet në mënyrë konstruktive dhe gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me standardet e sundimit të së drejtës, se të gjithë liderët politik duhet të vënë interesat nacionale para interesave të partive si dhe të ndërmerren hapa për përmbushjen e plotë të detyrimeve nga marrëveshja politike në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente, me fokus të veçantë edhe në përmbushjen e detyrimeve nga reformat urgjente prioritare.

[Më shumë](#)

Takime pune të Sekretares shtetërore Ana Blazheska

Sekretarja shtetërore z-nja Blazheska për në vizitë pune në Bruksel

Gjatë vizitës së saj Sekretarja shtetërore Blazheska realizoi takim me Drejtorin e ri për Ballkanin Perëndimor në kuadër të Komisionit Evropian, Genoveva Ruy Kalavera, e cila morri pozitën e udhëheqësisë në këtë Drejtori më 01.06.2016, në takim u diskutuan sfidat me të cilat ballafaqohemi si shtet, në procesin e reformave, si dhe masat të cilat duhet zbatohen në kuadër të procesit të Berlinit. Gjithashtu, u diskutua edhe Samiti i ardhshëm për Ballkanin Perëndimor e cila realizohet në Paris.

Në Bruksel, Blazheska realizoi takim edhe me raportuesin për Maqedonisë në Parlamentin Evropian, z. Ivo Vajgll, me të cilën shqyrtuan aktivitetet të cilat zbatohen në drejtim të përmbushjes së masave të parapara nga Plani i aktiviteteve për realizimin e Reformave Urgjente Prioritare. U potencua se fokusi, në periudhën e ardhshme duhet të vendoset në reformat dhe masat të cilat duhet ti zbatojë Republika e Maqedonisë me qëllim për fillimin e bisedimeve.

[Më shumë](#)



Sekretarja Shtetërore për Çështje Evropiane Ana Blazheska në Andorrë në takimin e tetë të nivelit të lartë "Forcat globale, zërat lokal"

Në takimin kushtuar globalizimit, znj. Blazheska foli në panelin e parë të takimit me temë "shqyrtimi i globalizimit".

Sekretari shtetëror Blazheska gjatë fjalimit të saj theksoi disa aspekte të globalizimit, duke folur për atë se çfarë mund të bëhet për të shmangur rritjen e pabarazisë e cila është e pashmangshme në epokën e globalizimit. Institucionet ekonomike dhe demokratike janë po aq të rëndësishme për të shmangur kurthin e të ardhurave të mesme të dhe të arrihet zhvillim i qëndrueshëm, sepse duhet të vendoset balancë midis demokracisë dhe ekonomisë, theksoi ajo.

[Më shumë](#)

Sekretarja shtetërore për Çështje Evropiane z-nja Ana Blazheska realizoi takim me delegacionin e nivelit të lartë nga Franca

Në takim u shqyrtuan mundësitë për bashkëpunim mes Maqedonisë dhe rajonit të Alzasit në drejtim të shkëmbimit të përvojave dhe bashkëpunim në fushat e turizmit, ekonomisë, konkurrencës, prodhimit dhe eksportit të verës dhe inovacione.



Rajoni Alzas është rajoni i parë në Francë që ka shfrytëzuar mbështetjen e fondeve evropiane dhe ka fituar përvojë të madhe në këtë fushë të cilën përvojë mund ta ndajë me vendin tonë për avancimin e përdorimit të ndihmës evropiane.

Delegacioni i lartë Francez qëndroi në Maqedoni nga data 19 deri më datën 22 qershor 2016. Qëllimi i vizitës është promovimi i rajonit të Alzasit dhe avancimin e bashkëpunimit ekonomik.

[Më shumë](#)



"BE Bisedime" - Debat me temë "Marrëveshja e Parisit - ndryshimet klimatike, menaxhimi me ujëra"

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit, e cila mbahet çdo vit më datë 5 qershor në korniza botërore, si dhe në kuadër të Bashkimit Evropian, Sekretariati për Çështje Evropiane në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ambasadën e Republikës së Francës organizuan debat në kuadër të projektit "BE Bisedime" me temë "Marrëveshja e Parisit për ndryshimet klimatike - menaxhimi me ujëra", ku morën pjesë përfaqësues të ministrive përkatëse, organizatat e shoqërisë civile dhe profesorë të universiteteve.

Zëvendëskryeministri Ademi në fillim të debatit theksoi se ndryshimet klimatike paraqesin sfidë globale dhe ata kryesisht ndikojnë në shëndetin e njeriut dhe gjithësisë së florës dhe faunës, duke pasur kështu pasoja serioze mbi ekonominë botërore, si dhe çdo rajon në mënyrë individuale. Për këtë shkak ndryshimet klimatike nuk mund të shihen si një sfidë individuale por drejt së njëjtës duhet të vepohet në mënyrë sistematike, bashkërisht dhe me përgjegjësi.

[Më shumë](#)



"BE në Maqedoni" - Kafe paузë me ambasadën e Mbretërisë së Holandës

Në këtë ngjarje morën pjesë përfaqësues të organizatave civile të të rinjve, të punësuar në Sekretariat për Çështje Evropiane dhe përfaqësues të mediave të cilët kishin mundësi në bisedë joformale me Zëvendëskryeministrin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përgjegjës për Çështje Evropiane Dr. Arbër Ademi dhe ambasadorin e Holandës SH.T. z. Vilem Vuter Plomp si dhe me të pranishmit tjerë të shkëmbejnë idetë, propozimet dhe mendimet e tyre.

Zëvendëskryeministri Ademi theksoi se Holanda, vend i cili tani kryeson me Këshillin e BE-së, si mik i vendit mbështet numër të madh të proceseve reformuese në fushën e sundimit të së drejtës

dhe demokratizimit, si dhe mundësitë për përmirësimin e administratës në kontekst të procesit të integritetit evropian.

[Më shumë](#)

IPA Projekte

"Sistemet e integruara për menaxhimin e mbeturinave të ngurta në rajonin lindor dhe verilindor"

Financuar nga: bashkimi Evropian

Qëllim i projektit: të përgatitet dokumentacioni i duhur për vendosjen e sistemit për menaxhimin me mbeturina ve rajonin lindor dhe verilindor.

Vlera e përgjithshme: 975,000 euro

Kohëzgjatja: janar 2016 - prill 2017

Shfrytëzuesi kryesor: Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor dhe bordet ndërkomunale për menaxhimin me mbeturina dhe komunat e dy rajoneve.

[Më shumë](#)

"Harmonizim i mëtejshëm me legjislacionin e BE-së në fushën e lëvizjes së kapitalit pagesave dhe shërbimeve financiare - tregu i letrave me vlerë dhe shërbimeve investuese"

Financuar nga: Bashkimi Evropian

Qëllim i projektit: të harmonizohet legjislacioni i tregut të brendshëm financiar me rregullat dhe normat e BE-së në fushën e tregut, kapitalit dhe shërbimeve të pagesave.

Vlera e përgjithshme: 1,264,000 euro

Shfrytëzuesi kryesor: Ministria e financave, komisioni i letrave me vlerë i BPRM.

[Më shumë](#)

BE Lajme

- [BE-ja miratoi masa të reja për avancimin e stabilitetit dhe luftës kundër shkaqeve kryesore të migrimit ilegal](#)
- [Tetë emra të reja për produktet e mbrojtura si shenja gjeografike](#)
- [U arrit marrëveshja midis kufirit Evropian dhe rojës bregdetare](#)
- [Komisioni propozon rregulla të reja për mbrojtje më të mirë të fëmijëve në kontestet ndërkufitare familjare](#)

A e dini se ...?

- 27 gram sheqer duhet të përmbajë një kanaqe me pije energjetike prej 250ml
- 80% e kompanive evropiane kanë pasur me pak një shkelje të sigurisë kompjuterike gjatë vitit të kaluar
- 70% e viktimave të trafikimit me njerëz janë femra

Ditët ndërkombëtare

- 15 korrik - Dita botërore dedikuar për aftësitë e të rinjve
- 30 korrik - Dita ndërkombëtare e shoqërisë
- 30 korrik - Dita botërore dedikuar luftës kundër tregtisë me njerëz

Ju Falënderojmë!